



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Zyra e Kryeministratit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister**

**Zyra për Planifikim Strategjik**  
**Kancelarija za Strateško Planiranje - Strategic Planning Office**

DATË/A:	02/05/2013
REFERENCË:	001-05-2013
PËR/ZA/TO:	Z. Shefki Ukaj, Kryetar i Komisionit të Pavarur për Media
CC	Znj. Dhuarata Hoxha, Këshilltare e Kryeministratit Z. Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministratit
NGA/OD/FROM:	Ruzhdi Halili, Drejtor Zyra për Planifikim Strategjik, Zyra e Kryeministratit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion për draft strategjinë për kalim nga transmetimi analog në atë digjital në Republikën e Kosovës

Inderuari Z. Ukaj,

I referohem shkreses suaj të datës 19 dhjetor 2012 me të cilën është proceduar në Qeveri draft i Strategjisë për kalim nga transmetimi analog në atë digjital në Republikën e Kosovës

Kjo shkresë lëshohet në bazë të përgjegjësive që Zyra për Planifikim Strategjik ka me Rregullorën për strukturën organizative të Zyrës së Kryeministratit, Udhëzimin Administrativ 02/2012 për kriteret, metodologjinë e përgatitjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre, si dhe Rregullorën e Punës së Qeverisë.

Hartimi dhe procedimi i draft Strategjisë është në pajtim Ligjin për KPM-në që përcakton se KPM duhet të procedoj në Qeveri për miratim draft strategjinë për kalim nga transmetimi analog në atë digjital. Draft strategjia është proceduar gjithashtu në pajtim me planin e dokumenteve strategjike për vitin 2013.

Megjithatë, konsiderojmë se ka një numër të çështjeve që Komisioni i Pavarur për Media duhet ti adresojë para procedimit te kësaj draft strategjie per miratim në Qeveri:

- Draft Strategjia për Digjitalizim me gjithëse në vija të përgjithshme përmend hapat që do të ndërmerren gjatë zbatimit ajo nuk përban një plan të qartë të zbatimit të saj. Plani duhet të përbajtë gjitha aktivitete specifike, afatet, institucionet dhe palët tjera përgjegjëse për zbatim, koston dhe burimet buxhetore që janë siguruar për zbatimin e aktivitetave të planifikuar. Plani përcakton të gjithë hapat që institucionet përgjegjëse duhet të ndërmarrin për të arritur qëllimet e synuara me strategji. Gjithashtu sa i perket analizës së situatës disa nga aspektet e draft strategjisë bazohen në të dhëna të cilat dalin nga raportet e vitit 2011 apo më të mëheershme për subjekteve e licencuara trasnmetuese. Të dhënët që dalin nga këto raporte konsiderojmë se mund të kenë ndryshuar dhe si rezultat mund të na shpijnë në ndërmarrjen e veprimeve që mund të jenë të gabuara.
- Duke ju referuar shkresës së përfaqësuesit të zyrës së BE-së në Kosovë z. Samuel Zbogar të datës 14 janar 2013 dërguar Kryeministrin, draft Strategjia për digjitalizim vlerësohet së nuk është në pajtim me standarde ITU-së, me dispozitat që përban Direktiva e Shërbimeve të Mediave Audiovizuale (AVMS), si dhe me instrumentet tjera ndërkombëtare. Harmonizimi i dokumenteve strategjike/politikave dhe legjisacionit me kriteret, politikat dhe legjisacionin e BE-së është një nga kriteret e integrimit evropian dhe objektivë strategjike e Qeverisë së Kosovës e cila duhet të merret parasysh nga ana e KPM-së.
- Secili dokument strategjik që procedohet në Qeveri për miratim duhet të ketë një vlerësim të implikimeve financiare të zbatimit të tij. Vlerësimin e implikimeve financiare të zbatimit si rregull e bën institucioni përgjegjës për hartimin e dokumentit ndërsa Ministria e Financave pas kësaj lëshon një deklaratë financiare rrëth mundësisë së zotimit të mjeteve buxhetore për zbatim të dokumentit. KPM ka përcaktuar një kosto totale prej 20 milion euro për zbatimin e strategjisë. Por ky është më shumë një vlerësim orientues sesa i bazuar në ndonjë analizë e mirëfilltë. Përveç përcaktimit të implikimeve financiare të zbatimit në dokument duhet të paraqiten informata rrëth burimeve financiare për zbatimin e dokumentit.
- Analizimi i qëndrueshmërisë së transmetuarve me rastin e kalimit në sistemin digjital të transmetimit dhe mundësia e gjetjes së opsiioneve më të përshtatshme për financimin e zbatimit të draft strategjisë kërkon një diskutim të mëtejshëm me institucionet dhe aktorët përkatës. Të kemi parasysh që me draft strategji do

të kërkohet mbështetje substanciale për zbatim të dokumentit në aspektin e subvencionimit të skemave sociale për blerjen e pajisjeve që mundësojnë qasjen në programe ndërsa alternativat e mjaftueshme për këtë opcion nuk duket se janë shqyrtar mjaftueshëm. Gjithashtu digjitalizimi mund të ketë ndikim në anën tjetër në masën e buxhetit që i ndahet Televizionit Publik për shkak të nevojës së avancimit të teknologjisë.

- Konsultimi dhe koordinimi me palët e interesit dhe institucionet që kanë përgjegjësinë për zbatim të obligimeve që dalin nga dokumentet strategjike është një kriter shumë i rëndësishëm që duhet të merret parasysh për secilin dokument strategjik që miratohet ne Qeveri. Konsiderojmë që kjo draft Strategji nuk ka informatat e mjaftueshme në lidhje me këtë çështje. Megjithëse, para fillimit të hartimit ishin krijuar një numër i mekanizmave koordinuese, prapë se prapë nuk është e qartë sa draft strategjia është hartuar dhe koordinuar plotësisht përmes tyre. Gjithashtu nuk ka informata në draft strategji se a është mbajtur ndonjë konsultim i gjerë me publikun dhe palët që preken nga zbatimi i draft strategjisë.

Ne jemi në dispozicion për të sqaruar më tutje vlerësimet të cilat janë dhënë në këtë shkresë dhe për të mbështetur KPM-në në finalizimin e kësaj draft Strategjie.

Me respekt.